



DEKLARATA /MESAZHI
I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
POLICISË SË KOSOVËS PËR SINJALIZIM
&

UDHËZUESI PRAKTIK PËR SINJALIZIM





Fehmi Hoti

UD. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

DEKLARATA / MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS

Si institucion i ndërtuar mbi vlerat e integritetit profesional dhe organizativ dhe bazuar në parimet e policimit demokratik, Policia e Kosovës do të fillojë zbatimin e sistemit të sinjalizimit brenda organizatës. Ky sistem synon ndërtimin e mekanizmave të nevojshme për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Si drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës mbështes masat e ndërmarra për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së sinjalizuesve brenda Policisë së Kosovës.

Sinjalizimi, si proces me mekanizmat e saj, do t'i ndihmojë Policisë së Kosovës luftimin e dukurive negative, ruajtjen e interesit publik, ngritjen dhe avancimin e besimit tek qytetarët, si dhe bashkëpunimin më të mirë në parandalimin dhe hetimin e hershëm të rasteve të keqbërjes dhe shkeljeve brenda organizatës tonë.

Policia e Kosovës mbetet gjithmonë e përkushtuar për të ruajtur dhe për të fuqizuar integritetin, besimin e qytetarëve dhe imazhin pozitiv të krijuar ndër vite, falë punës profesionale dhe angazhimeve të të gjithë punonjësve të Policisë.

Veprimet joetike dhe keqbërëse që dëmtojnë qëllimin tonë për të ndërtuar një shoqëri të sigurt dhe për të ofruar një shërbim cilësor ndaj komunitetit do të kenë zero tolerancë për çdo rrethanë apo veprime të cilat e dëmtojnë integritetin e Policisë së Kosovës.

Qëllimi i krijimit të mekanizmit për sinjalizim në Policinë e Kosovës është që të mundësojë, pranimin dhe trajtimin e raportimeve të veprimeve keqbërëse të punonjësve të Policisë në dëm të interesit publik dhe krijimin e strukturës përgjegjëse për zbatimin e këtij mekanizmi në të gjitha nivelet e përgjegjesisë.

Kjo strukturë do të jetë e organizuar në nivel qendror dhe lokal. Në cilësinë e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës kam caktuar zyrtarët përgjegjës për sinjalizim, të cilët bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve, do të trajtojnë të gjitha raportimet duke ndjekur procedurat përkatëse të miratuara për këtë qëllim.

Këta zyrtarë përgjegjës për sinjalizim kanë për detyrë të mbledhin dëshmitë, të intervistojnë dhe nëse gjejnë shkelje, të raportojnë gjetjet në organet përkatëse ndaj zyrtarëve, të cilët bëjnë veprime keqbërëse ndaj interesit publik.

Zyrtarët përgjegjës për sinjalizim janë pika kontakti për të gjithë ata që raportojnë. Kontakti me ta do të jetë i lehtë, i qasshëm dhe mbi të gjitha konfidencial.

Zyrtarët përgjegjës për sinjalizim trajnohen në vazhdimësi sipas praktikave më të mira të vendeve demokratike.

Ky udhëzues ofron informacione të nevojshme për sinjalizuesit mbi formën dhe mënyrën e raportimit, trajtimin e raporteve nga zyrtarët përgjegjës për sinjalizim, si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga çdo formë e keqtrajtimin.

Sinjalizuesit janë vlerë e çmuar për organizatën tonë në mbrojtje të interesit publik. Çdo formë e presionit, kërcënimit ndaj sinjalizuesit apo ndërhyrjes në këtë proces, me qëllim cenimin e tij, do të trajtohet dhe do të merren masa të rrepta konform procedurave të parapara dhe legjislacionit në fuqi.


Unë, si drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, inkurajoj të gjithë punonjësit e Policisë që në të gjitha rastet kur vërejnë veprime të punonjësve të Policisë që bien ndesh me etikën, profesionalizmin, rregullat, që dëmtojnë imazhin e Policisë së Kosovës, interesin publik, t'i raportojnë.

Raportimi do të kontribuojë në krijimin e një shërbimi efikas dhe efektiv, për një ambient më të mirë dhe më të sigurt për të gjithë ne.

UDHËZUES PRAKTIK PËR SINJALIZIM

A. HYRJE

Ky udhëzues praktik për sinjalizim është udhërrëfyes për të ndihmuar, për të qartësuar dhe për t'iu shërbyer të gjithë personave që raportojnë në interesin publik. Dokumenti jep sqarime të nevojshme dhe udhëzime për mënyrën e raportimit, vendin dhe personat që bëjnë raportimin, zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, përmbajtjen e raportimit. Dokumenti gjithashtu përcakton autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesit në rast të pësimit të ndonjë dëmi për shkak të sinjalizimit apo ndonjë veprimi hakmarrës, garancitë që ofrohen për ruajtjen e identitetit, konfidencialitetit dhe të dhënat personale, si edhe të drejtat e sinjalizuesit për t'u informuar me procesin, ecurinë dhe përfundimin e tij.



B. QËLLIMI

Ky udhëzues praktik ka për qëllim që të sensibilizojë dhe të inkurajojë të gjithë personelin policor dhe personat e tjerë që mund të bëjnë raport për sinjalizim, t'iu ofrojë informacione të nevojshme për procesin e sinjalizimit dhe përfundimin e këtij procesi.

UDHËZUES PRAKTIK PËR SINJALIZIM

C. PËRMBAJTJA

Udhëzuesi praktik ka këtë përmbajtje:

I. Përkufizimet

II. Informatat për sinjalizim

1. Kush mund të bëjë një raportim,

2. Çfarë mund të raportohet,

3. Çfarë nuk mund të raportohet,

4. Ku mund të raportohet,

5. Si mund të bëhet raportimi,

6. Si do të trajtohet raportimi juaj.

a. Pranimi dhe regjistrimi i raportit

7. Çfarë ndodh pasi të pranohet një raportim

a. Procesi i trajtimit të raportit dhe informimi

b. Procesi hetimor

c. Kërkesa për të dhënë informacione

d. Përfundimi i hetimit dhe informimi

III. Të drejtat e sinjalizuesit

IV. Të drejtat e personit të lidhur me sinjalizimin

V. Mbrojtja e sinjalizuesve

VI. Konfidencialiteti, ruajtja e identitetit dhe mbrojtja e të dhënave;

VII. Keqpërdorimi i sinjalizimit dhe pasojat.

UDHËZUES PRAKTIK PËR SINJALIZIM

PËRKUFIZIMET

1. Shprehjet dhe terminologjia të përdorura më poshtë kanë kuptim sipas përcaktimeve të nenit 3 të Ligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve:

1.1. Sinjalizues - çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.

1.2. Raportim ose shpalosje në interes publik - nënkupton raportimin ose shpalosjen e informacionit për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik.

1.3. Raportim - nënkupton raportimin brenda institucionit publik apo subjektit privat ose tek autoriteti kompetent.

1.4. Shpalosje - nënkupton bërjen publike të informacionit.

1.5. Person në kontekst të marrëdhënies së punës - personi fizik i cili është apo ka qenë:

1.5.1. në marrëdhënie pune në një institucion publik ose subjekt privat pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja ose pagesa;

1.5.2. bashkëpunëtor i jashtëm ose i rastit, vullnetar, në praktikë profesionale ose trajnim;

1.5.3. kandidat për punësim, aktivitete vullnetare, praktikë profesionale ose trajnim;

1.5.4. në marrëdhënie kontraktore punësh, shërbimesh ose lloje të tjera bashkëpunimi apo përdorim i shërbimeve të institucionit publik ose subjektit privat, përfshirë kontraktimin ose nënkontraktimin.

1.6. Punëdhënës - nënkupton çdo institucion publik dhe subjekt privat që i përket ndonjëres prej kategorive të përkufizuara sipas nën paragrafit 1.5 të këtij paragrafi.

UDHËZUES PRAKTIK PËR SINJALIZIM

11.7. Agjencia Kundër Korrupsionit ose ndonjë autoritet që ka të drejtë të marrë raporte në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me sinjalizimin në sektorin publik, ndërsa rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat.

1.8. Institucion publik - nënkupton organet, autoritetet dhe agjencitë publike në nivelin qendror dhe lokal që ushtrojnë kompetenca legjislative, ekzekutive, administrative, gjyqësore ose prokuroriale apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligj.

1.9. Zyrtar përgjegjës - personi i caktuar nga institucioni publik apo subjekti privat për të pranuar dhe për të trajtuar sinjalizimin.

1.10. Veprim i dëmshëm - çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që cenon interesin e ligjshëm të sinjalizuesit apo personit të lidhur me sinjalizuesin.

1.11. Person i lidhur me sinjalizuesin - personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin.

1.12. E dhënë personale - çdo informacion lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm siç përcaktohet me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

1.13. Informacion i klasifikuar - çdo informacion i klasifikuar siç përcaktohet me Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

INFORMATAT PËR SINJALIZIM

KUSH MUND TË BËJË NJË RAPORT?

1. Personat e mëposhtëm mund të bëjnë një raport sinjalizimi:

Punonjësit aktualë apo ish-zyrtarët e Policisë dhe personeli civil, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja apo pagesa e saj.



Bashkëpunëtorë aktualë ose të mëparshëm të jashtëm ose të rastit, vullnetarë, persona në stazh profesional ose marrëdhënie trajnimi.

Kandidatët për punësim, aktivitete vullnetare, praktikë profesionale apo trajnime, personat në marrëdhënie kontraktuale për punë, shërbime apo lloje të tjera të bashkëpunimit apo shfrytëzimit të shërbimeve të Policisë së Kosovës, përfshirë kontraktimin apo nënkontraktimin.

ÇFARË MUND TË RAPORTOJË?

Raportuesi mund të bëjë raportimin në rrethanat e mëposhtme sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve:

1. Raportimi dhe shpалosja në interes publik është e mbrojtur kur bëhet për shkak se:

- 1.1. shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet;
 - 1.2. personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështojë të përmbushë ndonjë detyrim ligjor;
 - 1.3. ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë;
 - 1.4. shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet;
 - 1.5. mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet;
 - 1.6. ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit të parave publike ose resurseve të një institucioni publik, kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë;
 - 1.7. një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keq menaxhim të rëndë;
 - 1.8. informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet që bien në ndonjë nga nënparagrafët e mësipërm ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar.
2. raportimi apo shpалosja do të supozohet se është në interes publik, përveç nëse vërtetohet e kundërta.

Rekomandim

Rekomandohet që të bëni raportin tuaj sa më shpejt që të jetë e mundur, nuk jeni të detyruar të vërtetoni mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit. Nëse nuk jeni të sigurt nëse çështja është sinjalizues apo jo, mund të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për sinjalizim për këshilla të mëtejshme.

ÇFARË NUK MUND TË RAPORTONI!

“Udhëzuesi praktik është për raportimin e çështjeve që kanë të bëjnë me interesin publik. Çështjet personale të punësimit (të tilla si ankesat rreth pakënaqësive ndaj kolegëve ose menaxherëve) normalisht nuk do të konsiderohen si sinjalizues, përveç nëse çështja është brenda fushëveprimit të nenit 5 të Ligjit (shih pjesën e mëparshme). Ju mund të raportoni çështjet personale të punësimit duke përdorur mekanizma të tjerë të brendshëm. Nëse nuk jeni të sigurt nëse çështja është sinjalizues apo jo, mund të kontaktoni një zyrtar përgjegjës për këshilla të mëtejshme.

KU MUND TË RAPORTOJ?



Raportet mund t'i drejtohen zyrtarit përgjegjës për sinjalizim i cili e vlerëson atë dhe e heton sipas nevojës.

Çdo drejtori rajonale si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës (DPP-ja) në Prishtinë ka një zyrtar përgjegjës të emëruar me vendim të drejtorit të Përgjithshëm. Zyrtari përgjegjës për sinjalizim ka për detyrë të pranojë dhe të hetojë raportet e sinjalizimit dhe të ruajë konfidencialitetin dhe identitetin e sinjalizuesit dhe çdo informacion.

Emri dhe detajet e kontaktit të çdo zyrtari përgjegjës gjenden në faqen e internetit dhe intranetin e Policisë. Sinjalizuesi duhet t'ia bëjë raportin e tij zyrtarit përgjegjës në zonën e tij. Në rrethana të caktuara, është gjithashtu e mundur që të raportohet drejtpërdrejt te drejtori i Përgjithshëm. Informacione të mëtejshme për këtë jepen më poshtë.

Sinjalizuesi raportimin e bën tek zyrtari përgjegjës për sinjalizim në territorin e rajonit ku punon. Të dhënat dhe informacionet e nevojshme për zyrtarin përgjegjës për sinjalizim mund t'i gjeni në faqen intranet (rrjetin e brendshëm të Policisë së Kosovës) dhe web faqe të Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com.

A MUND TË RAPORTOJ EDHE NDOKUND TJETËR?


“Në rrethana të caktuara të jashtëzakonshme raportet mund t’i bëhen drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Drejtori i Përgjithshëm ka të njëjtat detyrime ligjore si zyrtarët përgjegjës dhe duhet të mbrojë identitetin tuaj, të vlerësojë raportin tuaj dhe të hetojë aty ku është e nevojshme. Neni 17 paragrafi 4 i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve i përcakton rrethanat e jashtëzakonshme si më poshtë si dhe Neni 5 paragrafi 6 i Rregullores (QRK) Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit”.

Ju mund të bëni raport në interes publik te drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës në rast se keni dyshime të arsyeshme se:



1. Punëdhënësi nuk ka zyrtar përgjegjës;
2. Punëdhënësi nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve;
3. Zyrtari përgjegjës është ose mund të jetë i përfshirë në praktikën e dyshuar të sinjalizimit,
4. Për shkak të ndonjë marrëdhënieje ose shoqërimi me një person i cili është ose mund të përfshihet në çështjen e pretenduar në lidhje me sinjalizimin, nuk është personi i duhur për t'u informuar me sinjalizimin.
5. Procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.
6. Në rast të mungesës së zyrtarit përgjegjës;
7. Në rast se raportimi paraqitet nga, apo ndaj zyrtarit përgjegjës,
8. Apo në rast se zyrtari përgjegjës ka konflikt interesi.

Gjithashtu raportimi mund të bëhet dhe në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit sipas përcaktimeve të nenit 18 paragrafi 1 pika 1- 4 të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nëse:





Informatë me rëndësi

Në rast se raportimi juaj ka të bëjë me informacionin e klasifikuar, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, raportin ia paraqitni organit kompetent të këtyre fushave siç parashihet në Neni 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve. Të dhënat për drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës i gjeni në intranet (rrjeti i brendshëm i Policisë së Kosovës)
emri.mbiemri@kosovopoliice.com.

SI MUND TË RAPORTOHET ?



Raportimi mund të bëhet:

"Në faqen e internetit dhe në intranet ekziston një modul sinjalizimi i quajtur "sinjalizimi". Duke klikuar në këtë dritare, hapet informacioni i nevojshëm për sinjalizuesin dhe në hapat në vijim mundësohet përzgjedhja e zyrtarit përgjegjës të vendndodhjes më të afërt për sinjalizuesin. Aty do të gjeni emrin, adresën e e-mailit, telefonin fiks dhe celular.

Raportimet mund t'i bëhen një zyrtari përgjegjës në mënyrat e mëposhtme:

- Fizikisht duke e takuar zyrtarin përgjegjës.
- Me telefon (në zyrë nga ora 08:00 deri në 16:00) ndërsa në raste urgjente që nuk presin, në telefon mobil në çdo kohë.
- Përmes e-mail-it të përcaktuar enkas për sinjalizim.
- Përmes postës fizike në adresën e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.

Udhëzime për përdorimin e kanaleve të komunikimit



Sinjalizuesi mund të shfrytëzojë çdo formë të komunikimit me zyrtarin përgjegjës për sinjalizim të renditur në këtë pjesë.

Sinjalizuesi për të raportuar, mundet që personalisht të kontaktojë zyrtarin përgjegjës në zyrë të punës apo edhe jashtë ambienteve të punës në vendin dhe kohën që ndihet më i sigurt dhe më rehat.

Nëse sinjalizuesi dëshiron që të marrë kontakt me telefon zyrtarin përgjegjës për të paraqitur një raport, mund ta bëjë përmes njërit numër të telefonit që e ka të regjistruar. Nëse sinjalizimin e bën përmes telefonit, sinjalizuesi me vonë do të e nënshkruaj raportin e sinjalizimit që e përgatit zyrtari përgjegjës për sinjalizim.

Nëse sinjalizuesi dëshiron që raportimin ta bëjë përmes postës elektronike, e-maili i zyrtarit përgjegjës është i dedikuar vetëm për sinjalizim.

Nëse sinjalizuesi dëshiron që raportimin ta bëjë përmes postës së jashtme apo të brendshme atëherë zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe të sigurohet që nga jashtë nuk mund të lexohet si dhe në zarf të shënojë vetëm emrin e marrësit, në këtë rast zyrtarit përgjegjës për sinjalizim, me adresë të saktë.



SI DO TË TRAJTOHET RAPORTIMI JUAJ ?

“Pas pranimit të raportit nga zyrtari përgjegjës, informacioni evidentohet në regjistër. Ai duhet të përmbajë:

Datën e pranimit të raportit;

Emrin dhe mbiemrin e sinjalizuesit

Të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit

Institucionin e sinjalizuesit



Përmbajtjen e shkurtër të informatës



Kur bëni një raport duke përdorur një nga kanalet e informimit, do të ishte e dobishme nëse mund të jepni informacionin e listuar më sipër, ngase kjo do të ndihmojë zyrtarin përgjegjës të plotësojë regjistrin dhe do të reduktojë vonesat në proces. Është e rëndësishme të theksohet se me ligj mbrohet identiteti i sinjalizuesit. Këshillohet që sinjalizuesit të mos diskutojnë raportin e tyre me askënd në mënyrë që të mos zbulohet identiteti i tyre. Pasi të jetë pranuar raporti, sinjalizuesit do t'i sigurohen dëshmitë e raportit të paraqitur dhe një listë e çdo dokumenti të paraqitur brenda tij.

Për më shumë informacion shih nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L – 085”Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve (2018)

ÇFARË NDODH PASI TË PRANOHET NJË SINJALIZIM?

6.1 Çfarë ndodh pasi të pranohet një sinjalizim?

Procedura e brendshme e hetimit administrativ fillon nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar. Sinjalizuesi do të njoftohet për pranimin ose refuzimin e sinjalizimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të sinjalizimit. Nëse sinjalizimi është pranuar, atëherë zyrtari përgjegjës do të hetojë. Hetimi do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se dyzet e pesë ditë nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar (përveç se kur nga rrethanat e rastit kërkohet shtyrja e afatit, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dyzetepesë (45) ditë).

6.2. Procesi hetimor

Nëse sinjalizimi pranohet, një hetim administrativ do të kryhet nga zyrtari përgjegjës (ose nga drejtori i Përgjithshëm në raste të jashtëzakonshme kur kallëzimi i është bërë drejtpërdrejt atij). Zyrtari përgjegjës do të shqyrtojë dhe do të vlerësojë pretendimet. Gjatë këtij procesi ai/ajo mund të kërkojë informacion shtesë dhe dokumente përkatëse, të urdhërojë inspektive ose të marrë deklaratë nga persona për këtë çështje. Zyrtari përgjegjës mund të konsultohet edhe me ekspertë të fushës përkatëse. Në hetimin administrativ mund të marrin pjesë sinjalizuesi, personat e tretë me njohuri për informacionin e raportuar dhe ata që posedojnë dokumente përkatëse.

6.3. Garancia e procesit të rregullt

Secilës palë që merr pjesë në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt në përputhje me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative. Pala:

- Mund të japë deklaratë me shkrim;
- Mund të paraqesë prova ose opinione;
- Mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
- Ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij/saj;

Kërkesa për të dhënë informacion

Punëdhënësit i kërkohet ligjërisht të vejë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat.

Kërkesat për informacion duhet të marrin përgjigje sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se shtatë (7) ditë.

Nëse ndonjë person nuk përmbush detyrimet ligjore për bashkëpunim në hetimin administrativ ndaj tij do të fillohet procedurë disiplinore.

6.4. Përfundimi i hetimit

Pas përfundimit të hetimit, zyrtari përgjegjës do të njoftojë sinjalizuesin dhe drejtorin e Përgjithshëm për përfundimin e hetimit, gjetjet dhe rekomandimet brenda 15 ditëve. Drejtorit të Përgjithshëm i kërkohet të marrë masa të menjëhershme për aq sa është e mundur për të parandaluar ose për të penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme të aktivitetit të dyshuar të raportuar nga sinjalizuesi. Kur është e nevojshme, do të iniciohen procedura disiplinore kundër keqbërësit të supozuar.

6.5. Informacion shtesë i rëndësishëm

Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë çdo pretendim që ai ofron si sinjalizues.

Sinjalizuesi nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi ose shkelja e supozuar e interesit publik nuk është materializuar.

Sinjalizuesi ka të drejtë të ketë qasje në dosjen hetimore të sinjalizuesit dhe mund ta kërkojë këtë në çdo kohë nga zyrtari përgjegjës.

TË DREJTAT E SINJALIZUESIT:

“Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes së identitetit të tij. Burimi i informacionit të sinjalizimit do të mbahet konfidencial siç kërkohet me ligj. Këto të drejta garantohen me ligj, gjatë hetimit administrativ, pas përfundimit të hetimit administrativ dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës të sinjalizuesit, kur në rrethana të arsyeshme sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtje.

Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme. Punëdhënësi është i detyruar të mbrojë sinjalizuesin nga çdo veprim i dëmshëm dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për ndalimin e dëmit dhe eliminimin e pasojave të tij.


Nëse një sinjalizues beson se ai është duke pësuar, ka pësuar ose do të pësojë një veprim të dëmshëm, ai duhet ta raportojë këtë tek zyrtari i tij përgjegjës sa më shpejt të jetë e mundur.”

Për më shumë informacion shih nenet 7 dhe 16 të Ligjit Nr. 06/L –085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

TË DREJTAT E PERSONIT TË LIDHUR ME SINJALIZIMIN

- Personi i lidhur me sinjalizuesin gëzon të njëjtën mbrojtje si sinjalizuesi, nëse personi i tillë provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak të lidhjes së tij me sinjalizuesin.
- Personi që provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak se personi që ndërmer veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me të, gëzon të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si sinjalizuesi.
- Zyrtari përgjegjës gëzon të njëjtën mbrojtje ashtu si sinjalizuesi nëse provohet se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij në lidhje me pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit.
- Neni 8, paragrafi 1,2&3 i Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

'Nëse personat e lartpërmendur besojnë se janë duke vuajtur, kanë pësuar ose do të pësojnë një veprim të dëmshëm, duhet ta raportojnë këtë tek zyrtari i tyre përgjegjës sa më shpejt të jetë e mundur'.



MBROJTJA E SINJALIZUESVE

“Sinjalizuesit që bëjnë raporte që kualifikohen për mbrojtje sipas ligjit kanë të drejtën e disa mbrojtjeve ligjore. Këto mbrojtje janë të përfshira në nenin 9 paragrafi 1,2,37 dhe 4 të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, i cili parashikon si më poshtë: ”

1. Sinjalizuesi që raporton ose shpalos informata në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore.

2. Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes sipas këtij ligji, në rastet kur:

2.1. raporton ose shpalos informacion, siç është përcaktuar me këtë ligj.

2.2. me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë.

3. Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar.

4. Mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin sipas këtij ligji nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i interesit publik i pretenduar nuk është materializuar.

Sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë gjithashtu edhe mbrojtje institucionale nëse ndaj tij janë ndërmarrë veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit të parapara me nenin 22,23,24,25&26 të Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve si më poshtë:

1. Mbrojtje nga veprimet e dëmshme;

2. Dëmshpërblimi në rast të veprimeve të dëmshme;

3. Mbrojtje gjyqësore;

4. Barra e provës bie mbi punëdhënësin nëse sinjalizuesi ka pësuar nga veprimet e dëmshme për shkak të sinjalizimit si dhe në rast se zhvillohet procedurë disiplinore ndaj sinjalizuesit lidhur me pretendimin se ai ka paraqitur një raportim në interes publik me keqbesim, punëdhënësi e ka barrën që ta dëshmojë këtë keqbesim.

5. Kërkesëpadi dhe masën e sigurimit;

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT, IDENTITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE:

“Zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër që merr ose përpunon raportet e marra nga sinjalizuesit duhet ta mbajë konfidencial këtë informacion dhe identitetin e sinjalizuesit gjatë gjithë kohës. Ata nuk duhet të shpërndajnë ose t’ua transmetojnë informacionin palëve të treta brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos përdorin atë për qëllime të tjera, përveç me pëlqim me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor që lidhet me:

Hetimin
efektiv të
shkeljeve
ligjore;

Parandalimin e
kërcënimeve serioze
për sigurinë e shtetit,
shëndetin publik,
sigurinë publike ose
mjedisin;

Parandalimin
ose ndjekjen e
krimit;

Nevojën e
zbulimit për
interes publik
ose kur
kërkohe me
Ligj

Zyrtari përgjegjës dhe personat e tjerë nuk duhet të njoftojnë personin e përmendur në sinjalizim, përveç nëse kërkohet me ligj. Zyrtari përgjegjës duhet të marrë pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit nëse i kërkohet të japë informacion që mund të zbulojë identitetin e sinjalizuesit tek një autoritet kompetent për veprime që nuk mund të ndërmerren pa zbuluar identitetin e sinjalizuesit. Në rastet kur ligji kërkon zbulimin e identitetit të sinjalizuesit, zyrtari përgjegjës duhet të njoftojë sinjalizuesin për këtë fakt përpara se të zbulojë identitetin e tij/saj.



KEQPËRDORIMI I SINJALIZIMIT DHE PASOJAT

“Qëllimi i këtij udhëzuesi praktik është të mbështesë personelin e Policisë së Kosovës dhe personat në kontekst të marrëdhënies së punës që të bëjnë raporte për interesin publik.

Nuk duhet keqpërdorur qëllimisht.

1. Mbrojtja e sinjalizuesit përjashtohet vetëm në rastet që i parasheh Neni 10, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve si vijon:
 - 1.1. sinjalizimi nuk është kryer për shkaqet e përcaktuara në nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve;
 - 1.2. raportimi apo shpалosja kryhet në bazë të fakteve, informatave ose dokumenteve që sigurohen lidhur me dhënien e ndihmës juridike;
 - 1.3. sinjalizuesi raporton ose shpалos informacion që ai ka ose mund të ketë dijeni se është i rremë.

Personat që konstatohet se kanë abuzuar me skemën e sinjalizimit mund t'i nënshtrohen masave disiplinore. Në rast se niset procedim disiplinor kundër sinjalizuesit për pretendimin se ai ka paraqitur një raport me interes publik me keqbesim, punëdhënësi ka barrën të provojë/dëshmojë këtë keqbesim.”

